

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës  
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/317  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. K4/I65- 2 Prot.**  
**Nr. Dok. 202503386/2**

**Tiranë \_03/\_11\_/2025**

**Lënda :** *Rekomandime mbi inspektimin e kryer në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Dibër*

**Drejtuar:** **Drejtues i parë z. Artion DUKA**  
**Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër**

**PESHKOPI**

**Kryekomisar z. Mariglen DUÇI**  
**Shef i Komisarit të Policisë Dibër**

**PESHKOPI**

**Për dijeni:** **Drejtues Madhor z. Ilir PRODA**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë Dibër nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (**MKPT**), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, nenin 81 të ligjit nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë në Dibër.

Inspektimi u krye në datën 02.09.2025, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Vullnet Topalli, me detyrë nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

MKPT, bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të

emigrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria, azilkërkuessit, institucionet psikiatrike dhe shtëpitë e të moshuarve. Inspektimi ishte paparalajmëruar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit të MKPT-së, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e DVP Dibër z. Artion Duka dhe shefin e komisariatit, z. Altin Hila, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e vizitës së inspektimit të MKPT-së në mjediset ku mbahen personat e privuar nga liria në DVP Dibër.

Në vijim drejtuesit e institucionit informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen e kushtet, në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisariat dhe informoi për masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar<sup>1</sup>, në lidhje me përmirësimin e disa kushteve sipas normave dhe standardeve, për qëndrimin dhe trajtimin e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ndërkombëtare dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, i shoqëruar nga Shefi i Komisariatit, vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe atij të sigurisë, për evidentimin e kushteve në të cilat janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë, plotësimin e kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

---

<sup>1</sup> Shkresë Nr. K4/I57-2, Prot., datë 14.10.2024 “Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Dibër”.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore, në lidhje me praninë e sendeve që ekspozojnë dhunë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/të ndaluar/të arrestuar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona.

Nisur nga informacioni i drejtuesve të policisë, por dhe nga inspektimi i kryer në mjediset e sigurisë dhe të shoqërimit në këtë drejtori/komisariat, rezultoi se respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria dhe kushtet infrastrukturore në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, ishin sipas kriterëve, normave dhe parametrave teknike të parashikuar në procedurat standarde, që garantojnë sigurinë dhe trajtimin e këtyre personave.

Shefi i Komisarariatit, si dhe punonjësit e policisë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë, gjatë inspektimit në ambientet e këtij komisarati.

Nga informacioni dhe verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në përfundim të inspektimit të kryer në vitin 2024<sup>2</sup>, rezulton se:

1. Ishte plotësuar rekomandimi, për lyerjen dhe dezinfektimin në mënyrë vazhdueshme të dhomave të sigurisë në DVP Dibër, me qëllim garantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë në këtë institucion.
2. Ishte plotësuar rekomandimi për pajisjen me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, në Komisaratin e Policisë Dibër.
3. Ishte plotësuar rekomandimi, për vendosjen e orës së mbikëqyrjes policore në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, për personat e shoqëruar në organet e policisë dhe jo orën e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo orën kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.
4. Ishte plotësuar rekomandimi, për plotësimin me korrektësi të “Formularit të Raportit të Shoqërimit” nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, në zbatim të rregullave të përcaktuara në procedurat standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
5. Ishte plotësuar rekomandimi, për afishimin në ambientet e dhomave të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluari/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatët kryesisht.
6. Ishte plotësuar rekomandimi për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisarati.

---

<sup>2</sup> Kthim përgjigje të shkresës tonë me nr. 2377/1 prot., datë 04.11.2024, nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër.

7. Ishte plotësuar rekomandimi për trajnimin e punonjësve të policisë që janë përgjegjës për persona të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin si dhe njohja me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në Mjediset e Policisë”*.
8. Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi për evidentimin e shkeljeve në përgatitjen e projekteve të rikonstruksionit, të drejtorisë/komisiariatit të policisë Dibër dhe marrjen në dorëzim të këtij institucioni pas rikonstruksionit të plotë, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjithashtu, u evidentua se **nuk** ishin zbatuar rekomandimet në lidhje me:

9. Pajisjen me kompjuter dhe sistem audio-vizive, në zyrën për intervistimin apo marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisiariatit.
10. Plotësimin e organikës së Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmës mjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar brenda 12 orëve të vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë.
11. Vendosjen e tavolinave në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.
12. Krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
13. Afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisiariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut Tiranë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në DVP Dibër, ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 82/2024, *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022<sup>3</sup>.

---

<sup>3</sup> Kreu VII, pika 4/d, e procedurave standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte 4 (katër) dhoma shoqërimi, të cilat ndaheshin në dy (2) dhoma shoqërimi për meshkujt madhorë, një (1) dhomë shoqërimi për gra dhe një (1) dhomë shoqërimi për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe të mjaftueshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, ku garantohet dhe siguria e tyre. Gjithashtu, dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me nga 1 stol për të mundësuar qëndrimin ulur të personave, por mungonin tavolinat për qëndrimin e personave në konflikt me ligjin në këto ambiente. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen deri 3 persona për secilën dhomë.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral dhe ishin veshur me rrjetë teli. Në dhoma kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura, të lyera dhe të mbajtura pastër nga ana higjieno-sanitare. Në vlerësojmë se kushtet higjieno-sanitare janë shumë të rëndësishme në ambientet e privimit të lirisë dhe gjendja e tyre varet nga organizimi i punës dhe për këtë shkak, Avokati i Popullit kërkon vëmendje maksimale nga drejtuesit e komisariatit dhe stafi përgjegjës. Pastërtia e ambienteve është thelbësore pasi tregon qartë kujdesin ndaj të shoqëruarve në këtë institucion.

Dyert e dhomave ishin me profil hekuri, mbylleshin me çelës nga jashtë dhe kishin bravë të rregullt. Në pjesën e sipërme të derës së dhomave të shoqërimit ishte montuar një xham transparent dhe i armuar me përmasa 60x40 cm, (i pa çmontushëm dhe rezistent) hapësira e dritarës në derën e dhomave ishte e siguruar me një rrjetë teli, me shufra trashësie rreth 0.6 mm të cilët ishin vendosur në mënyrë vertikale dhe horizontale, me qëllim kryerjen e vëzhgimit dhe kontrollit ndaj të shoqëruarve nga personeli policor, sipas parashikimeve në procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në të gjitha ambientet e shoqërimit ishin vendosur etiketimet sipas dhomave të shoqërimit për të rritur, gra dhe të mitur, siç parashikohet në procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në hyrje të koridorit të dhomave të shoqërimit, ishte krijuar një dhomë intervistimi, e cila ishte e pajisur me dy karrige, një tavolinë dhe e monitoruar me kamera, por mungonte kompjuteri dhe sistemi audio/viziv. Sipas informacionit të stafit të institucionit zyrat e intervistimit do të pajisjen me të gjitha pajisjet e domosdoshme për të realizuar intervistimin e personave të shoqëruar, sipas parashikimeve në procedurat standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Deri në vënien në funksion të dhomës së intervistimit, marrja në pyetje dhe intervistimi i të shoqëruarve, vazhdonte të kryhej në zyrat e punonjësve të policisë, në kundërshtime me parashikimet e procedurës standarde të punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që*

*shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Avokati i Popullit e konsideron të papranueshëm faktin që për një kohë të gjatë Policia e Shtetit nuk e ka zbatuar këtë standard të parashikuar nga kuadri normativ në fuqi. Për më tepër shqetësues është fakti, që ky standard nuk plotësohet edhe kur bëhen rikonstruksione tërësore siç është rasti i Drejtorisë/Komisariatit të Policisë vendore Dibër.

Në Komisarlatin e Policisë Dibër, ndodhej një dhomë e ndarë me xham në mes për kryerjen e “përgjimit ambiental dhe njohje me persona nën hetime penale për veprime procedurale të bërë” nga punonjësi i policisë, sikurse parashikohet në ligj, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga organi i prokurorisë.

Në fundin e korridorit të dhomave të shoqërimit ndodhen dhe funksionojnë tualetet, të ndara më vete për gratë dhe burrat, me sipërfaqe të mjaftueshme dhe të kompletuara me lavaman e rubinet për ujin, si dhe me pajisjet e nevojshme hidrosanitare. Ambientet e brendshme furnizohen me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje nga rrjeti i Ujësjellës Kanalizimeve Dibër.

Në ambientet e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Dibër kishte sistem ngrohje/ftohjeje, me anë të kondicionimit sikurse parashikohet në procedurat standarde.

Në korridorin e ambienteve të shoqërimit ishin të instaluar 2 kamera sigurie të cilat shërbejnë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit. Ndërsa brenda dhomave të shoqërimit nuk kishte kamera siç përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfshijë tualetin) si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridorit të tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit, DPV, komisarlatet, stacionet e policisë”*.

Sistemi i kamerave të sigurisë do të shërbejë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit, si dhe do të monitorojë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimi në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre. Sipas informacionit, afati i ruajtjes së pamjeve filmike të siguruar nga kamerat e sigurisë ishte 15 ditë. Ky afat është në kundërshtim me *“Rregulloren për vendosjen dhe përdorimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme, të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin strukturat e Policisë së Shtetit”*<sup>4</sup>, në të cilën është e përcaktuar qartë se: *“Regjistrimet e kamerave të sigurisë do të ruhen për një periudhë deri në 60 ditë dhe më pas do të fshihen automatikisht”*<sup>5</sup>.

Ruajtja e pamjeve filmike të kamerave të sigurisë, sipas legjislacionit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare për këtë qëllim, në vlerësimin e Avokatit të Popullit, përbën

---

<sup>4</sup> Miratuar me Urdhrin Nr.1301, datë 03.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

<sup>5</sup> Afati i ruajtjes së pamjeve filmike audio-vizive në ambientet e privimit të lirisë së personit, nuk është e standartizuar por referuar ligjit nr. 19/2016 “Për masa shtesë të sigurisë publike” neni 8/a përcakton se përdorimi i sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj.

një provë të pakontestueshme në procesin e hetimit penal dhe administrativ për rastet që konstatohen kryerje e veprimeve të kundraligjshme si nga personat e privuar nga liria në mjediset e policisë apo dhe nga punonjësit e policisë ndaj tyre. Njëkohësisht, vendosja e sistemit të kamerave në mjediset e brendshme të policisë dhe ruajtja e pamjeve filmike brenda një afati të arsyeshëm, ka efekt parandalues ndaj veprimeve të kundraligjshme që mund të kryhen brenda këtyre mjedisëve.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar, dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet këtyre personave nga ana e punonjësve të policisë. Ndërkohë, në Komisariatit e Policisë Dibër, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 02.09.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **104** persona, nga të cilët saktësisht **98** shtetas madhorë, 5 shtetas të mitur dhe **1** shtetase gra të shoqëruara në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe nenin 21/1 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Gjatë inspektimit u evidentua se situata me njohjen e të drejtave ishte përmirësuar dukshëm në këtë komisarjat, ku në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, të cilët ishin të afishuar edhe brenda dhomave të shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshëm nga personat e shoqëruar për tu njohur me këto të drejta. Në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa, drejta në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Nga komunikimi me punonjësit e shërbimit në zyrën e informacionit, konstatuam se personave të shoqëruar ju jepej një kopje e kartës me të drejtat e tyre në momentin që ata hynin në dhomat e shoqërimit.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me “*Kartën e të drejtave*” në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarjat policie. Nëpërmjet “*Kartës së të drejtave*” qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“*Karta e të Drejtave*” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të “*Kartës së të Drejtave*” është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Gjithashtu edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës në vijim (CPT)-ja, përshtendeti zhvillimi e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyren e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit duhet të shkruajnë e lexojnë dhe e kuptojnë përmbajtjen e kartes.

Në strukturën organike të DVP Dibër, janë 16 specialistë policie, që kryejnë funksionin e OPGJ-së për rastet e hetimit të veprave të rënda penale dhe njëkohësisht ata kryejnë veprimet procedurale të marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar. Në këtë institucion kishte 8 zyra pune të OPGJ-ve dhe nga inspektimi i këtyre zyrave, nuk u gjendën sende apo mjete që ekspozojnë dhunë te personat e shoqëruar gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të tyre.

Gjithashtu, në Komisariatit e Policisë Dibër, ndodheshin 2 zyra të cilat shërbenin si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ). Ky ambient ishte i pajisur me tavolinë, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orënditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit<sup>6</sup>.

Në Komisariatit e Policisë Dibër, kishte 2 dhoma të etiketuara të cilat shërbenin për mbajtjen e provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisaritit provat materiale futen në një qese të etiketuar në këtë ambient<sup>7</sup>.

Nga monitorimi, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme të shoqërimit të personit në polici, ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisaritit, mbahej “Procesverbali i veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar” (lidhja model nr.3) të procedurës standarde, një kopje e të cilit e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatit e Policisë Dibër, ambienti i sigurisë ishte përgjithësisht i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurën standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr.1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ambientet e sigurisë ishin në katin e parë të godinës. Gjithsej kishte 7 dhoma sigurie me kapacitet total për 9 persona. Konkretisht 5 dhoma me nga 1 (një) person secila, ndërsa 2 dhoma të tjera me 2 (dy) persona, ishin të ndara më vete për meshkuj madhorë, 1 për gra dhe 1 për të mitur. Sipas aktit të procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesave të tyre*”, miratuar me urdhrin nr. 1720, datë 20.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhomat e sigurisë janë të organizuara në dy ambiente, në ambient qëndrimi dhe në paradhomë, të ndara me njëra-tjetrën me një skarë hekuri dhe derë që mbyllet me çelës, si dhe në ambientin për jetesë dhe në paradhomën që shërbente për qëndrimin e personave në orare të caktuara dhe për pastrim vetjak.

Sipas kriterëve për ndërtimin e dhomave të sigurisë<sup>8</sup>, normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë për një person të arrestuar/ndaluar janë që sipërfaqja e përgjithshme

---

<sup>6</sup> Kreu VI, Pika 4/g e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

<sup>7</sup> Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale “Vulosja e sendeve të sekuestruara”.

<sup>8</sup> Kreu VIII, pika 3 e procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*” miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023.

e ambientit duhet të jetë jo më pak se 10 m<sup>2</sup>, e cila duhet të ndahet në ambient qëndrimi me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>. Lartësia e këtyre ambienteve duhet të jetë jo më pak se 2.5 m. Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se, dhomat në ambientin e sigurisë në Komisaratin e Policisë Dibrë, plotësojnë kriteret e mësipërme.

Gjithashtu, çdo dhomë ishte pajisur me një krevat metalik me këmbë të palëvizshme, të kompletuar me orenditë e nevojshme për jetesë, si dyshek, batanije dhe jastëk, të cilët ishin në gjendje të mirë dhe të pastra. Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda dhe lavamanë. Mjediset e dhomave të sigurisë ishin të mirëmbajtura, të lyera dhe të mbajtura pastër nga ana higjieno-sanitare.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (2 dushe), i cili ndodhej në fund të korridorit. Ambienti ku ndodhej dushi me ujë të ngrohtë për larjen e trupi dhe tualetet, ishte i pajisur me nyje hidrosanitare dhe furnizohej me ujë të rrjedhshëm, nga rrjeti i UK Dibrë. Po ashtu në paradhomën e dusheve kishte dhe tualet të përbashkët, i cili ishte i pajisur me të gjitha pajisjet që shërbenin për këtë qëllim.

Në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje/ftohjeje me sistem qendrore sipas kushteve klimaterike, sikurse parashikohet edhe në procedurat standarde për *“Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevojë apo emergjence. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, si dhe me frigorifer për ruajtjen e ilaçeve të emergjencës, të cilat kërkojnë të mbahen në kushte frigoriferike. Në një raft, mbaheshin kartelat mjekësore me dinamikën e vizitave mjekësore për çdo person të ndaluar/arrestuar. Nga këqyrja e regjistrit të mjekut vërejmë se ishte plotësuar në çdo rubrikë për evidentimin e të dhënave shëndetësore për personat që ju privohet liria në ambientet e këtij komisarati. Kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit/arrestuarit paraqitet e përkeqësuar, me rekomandimin e mjekut, personi shoqërohet menjëherë për në Spitalin Rajonal të Dibrës. Sipas informacionit të drejtuesve të komisaritit, mjeku është me kohë të pjesshme në institucion.

Mungesa e mjekut/ndihmësmjekut me kohë të plotë është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në ligj dhe në procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, si dhe aktet ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë qartë kryerjen e detyrueshme të vizitës mjekësore brenda afatit 12 orë, nga koha e hyrjes të personave të ndaluar/arrestuar në ambientin e sigurisë. Pavarësisht se të ndaluarit/arrestuarit nuk kishin ankesa në këtë drejtim, mjeku/ndihmësmjeku duhet të ishte i pranishëm sa herë që ishte e nevojshme apo kërkohej ndihmë mjekësore nga të ndaluarit/arrestuarit. Kryerja e vizitave mjekësore dhe evidentimi i tyre në kartelë dhe regjistrin përkatës të Komisaritit të

Policisë<sup>9</sup>, janë detyrim ligjor për mjekun/ndihmësmjekun, por dhe për drejtuesit dhe punonjësit e policisë, pasi duhet të garantojnë shërbimin shëndetësor të nevojshëm ndaj këtyre personave, gjatë gjithë periudhës që ata ndodhen në mjediset e policisë.

Mekanizmi Kombëtar konstaton në mënyrë përsëritur se mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente dhe si rrjedhojë pasojat mund të jenë të rënda.

Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, i cili ka rekomanduar se: ***“Autoritetet shqiptare të marrin masat e nevojshme për të siguruar që dispozitat e procedurave standarde që kanë të bëjnë me ekzaminimin fillestar mjekësor të personave të ndaluar të zbatohen me rigorozitet në praktikë”.***

Në ambientin e sigurisë ndodhej edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët privatë, e cila shërbente njëkohësisht edhe për marrjen në pyetje të këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me 2 karrige, një tavolinë dhe një kompjuter për kryerjen e intervistimit të ndaluar/arrestuarve, Gjithashtu, ishte monitoruar dhe me kamera por brenda saj **nuk** ishte instaluar sistemi audio-viziv për vëzhguar veprimet e policisë me personat e ndaluar/arrestuar, si dhe për të parandaluar çdo kundërveprim të tyre ndaj punonjësve të policisë.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e kamerave përgjatë 24 orëve. Ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë dy javore.

### **Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.**

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Dibër nuk kishte asnjë person të shoqëruar, ndërsa në dhomat e sigurisë ndodheshin 2 (dy) persona të arrestuar, të cilët sapo ishin vendosur në dhomat e sigurisë.

Nga këqyrja e regjistrit për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, për periudhën 01.01.2025-02.09.2025, ishin evidentuar në këtë regjistër 48 persona, nga të cilët saktësisht 47 shtetas madhorë meshkuj dhe 1 shtetase grua të ndaluar/të arrestuar në konflikt me ligjin. Sipas shënimeve në regjistër, nuk rezultoi të kishte mbipopullim në dhomat e sigurisë, në asnjë periudhë kohore.

Nga intervistimi me personat e arrestuar, grupi i inspektimit konstatoi se, ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së arrestimit/ndalimit për ekzekutimin e vendimit të gjykatës apo urdhrit të prokurorit, shoqërimit në mjedisin e DVP Dibër, marrjes në pyetje nga specialistët/oficerët e policisë gjyqësore, si dhe gjatë qëndrimit në dhomat e sigurisë. Të intervistuarit nuk paraqitën asnjë ankesë për keqtrajtim nga punonjësit e policisë dhe nga punonjësit e shërbimit në ambientin e sigurisë gjatë procesit të marrjes në pyetje, si

---

<sup>9</sup> Kreu II, pika 7, e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në Policinë e Shtetit” miratuar me Urdhrin Nr.894, datë 29.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

dhe nuk kishin pretendime për trajtim denigrues, jo human, apo për ushtrim të dhunës fizike e psikologjike ndaj tyre.

Në vijim, nga intervista me personat e arrestuar, u evidentua se tualeti ishte pajisur me detergjentë, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, si kusht për mbajtjen e higjienës personale, por dhe ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Nga informacioni i drejtuesve të komisariatit dhe punonjësve të policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë, personat e ndaluar/arrestuar trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 *“Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”*. Ushqimi gatuhej në mensën që ndodhej brenda territorit të komisariatit dhe shërbehej sipas vakteve nga kuzhinerët dhe punonjësit e policisë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë<sup>10</sup>.

Gjithashtu, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër nuk ka ambiente ajrimi për persona të ndaluar/arrestuar siç parashikohet në Kreun VI, pika 1.14 të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 *“Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, ku thuhet se: *“Personi i ndaluar/arrestuar mund të dalë në ajrim sipas mundësive dhe kushteve që kanë ambientet e dhomave të sigurisë, por jo më pak se dy orë në ditë (për ato ambiente sigurie që nuk plotësojnë kushtet për ajrim e ndriçim të plotë natyral)”*.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës inspektuese nuk rezultoi ndonjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë, ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Sipas parashikimeve në dispozitat e ligjit nr. 82/2024, *“Për Policinë e Shtetit”*, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, çdo njësi policore ku ka dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie, duhet të jetë e pajisur me regjistrat përkatës.

---

<sup>10</sup> Kreu VII, pika 1.19 e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, ku parashikohet se: *“Brenda ambienteve të qëndrimit të dhomave të sigurisë, të arrestuarit/ndaluarit kanë të drejtë të ushtrojnë ritet fetare duke mos prishur rregullin në këto ambiente dhe pa shqetësuar të arrestuarit/ndaluarit e tjerë”*.

Theksojmë se, nga verifikimi i regjistrave dhe librave të shërbimit në Komisaratin e Policisë Dibër, u evidentua se regjistrat ishin të sekretuar dhe vulosur, sikurse përcaktohen në modelet tip të miratuar në procedurat standarde.

Konkretisht, në zyrën e informacionit ndodhej “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” sipas tipit “Model nr.1”, konform me procedurën standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjister nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>11</sup>

Në këtë komisarjat mbahej dhe regjistri me të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë njëherësh për Komisarjatet e Peshkopisë, Bulqizës dhe Matit, në varësi të DVP Dibër. Në procesverbalin e arrestimit apo ndalimit, ishte shënuar ora kur personat ishin mbajtur të shoqëruar në mjediset e policisë, pra në momentin kur atyre ju ishte privuar liria.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në këtë Komisarjat kishte regjister për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në këtë institucion mbahej regjister për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë muajit janar të vitit 2025 kishte 5 të mitur në konflikt me ligjin, sipas procedurës standarde (Lidhja model 5).

Në Komisaratin e Policisë Dibër u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjister për takimet me avokatin mbrojtës dhe prokurorin, regjister të vizitave mjekësore, regjister të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjister të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe në disa gjuhë të huaja.

---

<sup>11</sup> Kreu VII, e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor në funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë në Dibër, punonjësit e policisë gjyqësore i kryenin intervistat dhe marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës së kompjuterave dhe sistemit audio-viziv në zyrën e veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë, ishte një dhomë intervistimi, e cila ishte e pajisur me dy karrige, një tavolinë dhe një kompjuter. Gjithashtu ishte e monitoruar me kamera, por mungonte sistemi audio/viziv. Megjithatë kjo dhomë i plotëson pjesërisht standardet e kërkuara, pasi referuar kapaciteteve ishte e pamjaftueshme për të mbuluar punën e të gjithë oficerëve të policisë gjyqësore me personat e arrestuar/ndaluar. Kjo tregon se 16 oficerët e policisë gjyqësore të cilët punojnë në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër kanë vështirësi të intervistojnë të gjithë personat e arrestuar/ndaluar në këtë zyrë dhe praktika e marrjes në pyetje në zyrat e tyre të punës nuk duhet të vijojë.

Në lidhje me ambientet e intervistimit, Avokati i Popullit në zbatim edhe të rekomandimeve të CPT-së, ka rekomanduar në vijimësi marrjen e masave për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Nga inspektimet periodike që zhvillon MKPT-ja në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë, konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar<sup>12</sup>.

**Avokati i Popullit** e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar të arrestuar/ndaluar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, vetë punonjësit e policisë së shtetit ashtu dhe ndaj të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve.

Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

*Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo*

---

<sup>12</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”.

*do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.*

***CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar”<sup>13</sup>.***

Grupi i inspektimit, ka evidentuar si një praktikë të mirë në Komisaratin e Policisë Dibër, krijimin e një mjedisi të ri të quajtur *“Hapësirë miqësore për fëmijët”*, që shërbente për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të mitur në konflikt me ligjin. Ky ambient, përbëhej nga 3 dhoma të kompletuara me pajisje dhe orëditë e nevojshme për mbrojtjen dhe trajtimin dinjitoz të të miturit, viktimë e një veprë penale, gjatë procesit të hetimit.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë komisarariat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi, se për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip *“Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”*. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar *“Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”*.

Në dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në nenet 34/a, gërma “c” dhe 34/b gërma “a”, si dhe në ligjin nr. 84/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, në pikën 4 të nenit 19, përcaktohet se: *“Çdo shtetas në momentin e privimit të lirisë në mjediset e Policisë së Shtetit, ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin mbrojtës”*.

Gjithashtu, nga mbikëqyrja e fashikullit të dosjes për persona të shoqëruar ndaluar/arrestuar, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhorë, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, duke krijuar mundësinë për të kontaktuar me të. Koha më e zgjatur në marrjen kontakt të personit të privimit lirisë me avokatin ishte afërsisht 2 orë.

Në korridorin e ambienteve të shoqërimit të DVP Dibër ishin të afishuara lista për avokatët kryesisht të miratuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, të përditësuar për vitin 2025,

---

<sup>13</sup> Electronic recording of police intervistës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, personave të arrestuar/ndaluar iu respektohej e drejta për avokat mbrojtës kryesisht, në rastin kur të ndaluarit/arrestuarit nuk kanë mundësi financiare, nga lista e avokatëve të miratuar nga organi i prokurorisë sikurse parashikohet në Kodin e Procedurës Penale.

Sipas informacionit të stafit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 2 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të arrestuarit me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

Përgjatë inspektimit, punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut, i cili sigurohej nga Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, por edhe në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të qytetit.

Ndërkohë, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit mungonte lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. **Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm, që në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisarariat veçanarisht për të mitur në konflikt me ligjin**, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut part-time kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*<sup>14</sup>.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Nga informacioni i marrë nga stafi, u informuam se shërbimet shëndetësore për personat e ndaluar/arrestuar kryhen nga mjeku i emëruar me kohë të pjesshme në këtë institucion, ndërsa për raste urgjente të ndaluarit/arrestuarit dërgohen në Spitalin Rajonal Dibër.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Dibër ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ato ishin të vendosura në korridoret e këtyre ambienteve, dhe ishin të afishuara dhe në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, me qëllim që të jenë të aksesueshme nga këta persona.

---

<sup>14</sup> Kreu V, pika 7.2 e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”* miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023.

Për shtetasit e ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Nga rradhët e punonjësve të policisë të këtij komisariati, ishin trajnuar dhe specializuar 2 punonjës policie që administronin dhe asistonin procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme, për pajisjen me kompjuter dhe sistem audio-viziv, në zyrën për intervistimin apo marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit<sup>15</sup>.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese brenda ambienteve të dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Dibër.
3. Të merren masat e nevojshme teknike, për sigurimin e ruajtjes së pamjeve nga kamerat e sigurisë, deri në 60 ditë, sikurse përcaktohet në “Rregulloren për vendosjen dhe përdorimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme, të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin strukturat e Policisë së Shtetit”.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e organikës së Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmës mjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar brenda 12 orëve të vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë.
5. Marrjen e masave për vendosjen e tavolinave në dhomat e shoqërimit sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

---

<sup>15</sup> Kreu VI, pika 4/i1 e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

6. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut Tiranë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI  
i Mekanizmit Kombëtar  
për Parandalimin e Torturës  
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI**

**dv**